

Bashkim Aljji, PhD¹

UDC: 28-74-188

**PËRKUJDESJA SHPIRTËRORE NË DRITË TË INTENCAVE TË
LEGJISLACIONIT ISLAM**

**ДУХОВНАТА ГРИЖА ВО СВЕТЛИНАТА НА НАМЕРИТЕ НА
ИСЛАМСКОТО ПРАВО**

SPIRITUAL CARE IN LIGHT OF THE INTENTS OF ISLAMIC LAW

Abstract

This paper addresses the issue of the practice of spiritual care in public institutions in the West, considering its relevance to the principles of Islamic legislation. It argues that spiritual care is one of the five essential protections that must be safeguarded, particularly as it relates to the preservation of life and intellect. The paper asserts that spiritual care can be understood as having a legitimate and unique significance, warranting its inclusion among the higher objectives (maqasid) of shari' a that merit attention and protection. This conclusion is supported by the following key arguments:

1. The protection of life is one of the five core necessities that Islamic law seeks to preserve.
2. Islamic law provides a comprehensive framework for ensuring human well-being, both materially and spiritually.
3. One of the primary aims of shari' a is the promotion of justice, and providing spiritual care to those in need, such as the sick, prisoners, and asylum seekers, represents an essential aspect of the justice advocated by Islam.
4. Islam emphasizes solidarity and offering help to others in various forms, including physical, psychological, and spiritual

¹ Doktor në fushën e studimeve evropiane për integrim & këshillues shpirtëror në institucionet korrektuese në qytetin e Cyrihut-Zvicër.

support. This is viewed as an expression of compassion and charity, which is a fundamental principle in Islamic legislation.

By aligning spiritual care with these essential protections and objectives, the paper highlights its significant role in upholding justice and well-being within Islamic ethical and legal frameworks.

Keywords: *Spiritual care, Islamic legislation, Maqasid al-Sharia, protection of life, justice, patient care, sharia intents.*

Hyrje

Shërbimi i përkujdesjes shpirtërore po zë gjithnjë e më shumë vend në institucione publike në vende të ndryshme dhe është objekt diskutimi, si dhe punohet në sistematizimin e tij në shumë vende të botës, përfshirë edhe vendet me shumicë myslimane, të cilat njihen edhe si “Vende myslimane”, si për shembull: Maroku, Turqia, Egjipti, etj. Thelbi i veprimtarisë së përkujdesjes shpirtërore ka qenë prezent në forma të ndryshme në institucionet fetare dhe komunitare, ndërkaq në mënyrë josistematike edhe në institucionet publike. Në Zvicër, ku veprimtaria e përkujdesjes shpirtërore të krishtere ka një traditë të gjatë, me ardhjen e migrantëve, azilantëve dhe punëtorëve fizikë, shumica e të cilëve janë të përkatësisë islame, u paraqit nevoja për përkujdesjen shpirtërore myslimane në institucionet publike, me theks të veçantë: në spitale, burgje, qendra të azilit dhe shtëpi të pleqve.

Të parët që kryen këtë veprimtari ishin imamët, të cilët ishin prijës fetarë të komuniteteve të tyre dhe u shërbenin atyre. Ata kishin kualifikimin e duhur fetar islam për të folur për çështjet fetare. Megjithatë, këta imamë kryesisht e ushtronin këtë veprimtari në cilësinë e imamit, dhe jo si përkujdes tipik shpirtëror, ashtu siç është sistematizuar kjo veprimtari në kontekstin fetar të krishterë në Zvicër. Kështu, lindi nevoja për të trajnuar imamët dhe persona të tjerë në fushën e “Përkujdesjes shpirtërore myslimane”, në mënyrë që të jenë të përgatitur për t’u përballur me sfidat dhe kërkesat e kësaj veprimtarie në institucionet publike të një shoqërie multikulturore dhe të një shteti shekullar.

Megjithatë, duke marrë parasysh se imamët janë të lidhur ngushtë me veprimtarinë fetare në komunitetin mysliman dhe se ata kanë ardhur në Zvicër në cilësinë e imamit, duke shërbyer për një kohë të gjatë nëpër xhami, prania e tyre në institucionet publike në rolin e përkujdesjes

shpirtërore nuk është perceptuar nga publiku si një veprimtari e ndarë nga roli i imanit. Me fjalë të tjera, kur përkujdesja shpirtërore prezantohet nga myslimanët para një pale të caktuar, ajo e lidh automatikisht me imamin, pasi imami njihet si figura që kupton fenë islame dhe ka kualifikimin për të folur për çështjet fetare, përfshirë këtu edhe përkujdesjen shpirtërore. Sidoqoftë, shumica e myslimanëve ende e shohin përkujdesjen shpirtërore si pjesë të veprimtarisë fetare.

Kjo qasje mbështet funksionin e këshilltarëve shpirtërorë, pasi angazhimi i tyre lidhet drejtpërdrejt me formësimin e konceptit për njeriun (Menschenbild) në teologjinë islame, i cili manifestohet në tekstet e Kur'anit. Kur'ani e përshkruan njeriun si "Halifetullah" - Mëkëmbës i Zotit në tokë, çka i jep atij role dhe detyra të caktuara në botë, të cilat nuk mund t'i përmbushë pa një shëndet fizik, mendor dhe shpirtëror të qëndrueshëm. Për të qenë i aftë të mendojë, planifikojë dhe punojë, njeriu ka nevojë për mirëqenie të plotë.

Nëse njeriu lihet pa përkujdesje fizike, shpirtërore dhe mendore, ai nuk mund ta realizojë këtë rol. Përkujdesja shpirtërore (Seelsorge), me angazhimin e tij, kontribuon në realizimin e konceptit islam të njeriut si "Halifetullah" (Mëkëmbës i Zotit në tokë), duke qenë pranë tij në momentet e vështirësisë dhe fatkeqësisë, duke ofruar këshilla, empati dhe ndihmë. Ky përkujdesje i ndihmon individit të përballojë fatkeqësinë që e ka goditur, duke ruajtur shëndetin shpirtëror dhe mendor. Kjo shmang humbjen e shëndetit fizik, e cila do ta pengonte njeriun ta përmbushë rolin e tij si mëkëmbës i Zotit në tokë.

Intencat e legjislacionit islam

Një dimension i rëndësishëm i së drejtës islame janë intencat e legjislacionit islam (Mekasidu esh-Sheri'a), të cilat kanë për qëllim objektivat që legjislacioni islam synon të realizojë për interesin e njerëzve. Në mënyrë të përmblëdhur, mund të thuhet se intenca e përgjithshme që legjislacioni islam synon të përmbushë është: "Lumturia e individit dhe e bashkësisë, mbrojtja e rendit shoqëror dhe ndërtimi i tokës me çdo gjë që sjell të mirën dhe përkryerjen e njeriut, në mënyrë që kjo botë të shërbejë si përgatitje për botën tjetër, dhe njeriu të arrijë lumturinë në të dy botët."²

² El Alim, Jusuf Hamid, (pa vit botimi), *El Mekasidul amme lish sheria el islamijje*, Darul hadith-Kajro & Al Dar Al Soudania for Books-Khartoum, f. 83.

Për intencat e legjislacionit islam janë dhënë definicione të ndryshme, dhe në këtë rast do të mjaftohemi me definicionin vijues: Intencat e legjislacionit islam janë nocione, urtësi dhe parime që Ligjvënësi i ka marrë në konsideratë në mënyrë të përgjithshme dhe specifike, me qëllim që të realizojë interesat e njerëzve.”³

Ndarja e intencave të legjislacionit islam

Dijetarët kanë sqaruar se intencat e legjislacionit islam ndahen në tre grupe, ose siç shprehet edhe Shatibiju: “Këto intenca nuk i tejkalojnë tre grupe: 1. Të domosdoshme; 2. Të nevojshme; 3. Të parapëlqyera.”⁴

Dijetarët i kanë përmbledhur intencat e domosdoshme në pesë gjëra: mbrojtja e fesë, e jetës, e gjenezës, e pasurisë dhe e mendjes. Pra, në pesë domosdoshmëritë bën pjesë edhe mbrojtja e jetës dhe mbrojtja e mendjes.⁵

Këto pesë domosdoshmëri, dijetarët i kanë quajtur edhe pesë gjërat e tërësishme dhe universale, të cilat i konsiderojnë si baza dhe objektiva të përgjithshme të legjislacionit, që ai synon t’i mbrojë.⁶ Të dy këto reflektojnë fuqishëm në veprimtarinë e përkujdesjes shpirtërore, ngase kurimi dhe mbrojtja e shëndetit janë prej intencave të sheriatit, me qëllim që të mbrohet jeta dhe mendja e njeriut. Kjo, ngase kurimi dhe mbrojtja e shëndetit nuk nënkuptojnë vetëm mbrojtjen e shëndetit dhe kurimin fizik, por përfshijnë edhe kurimin dhe mbrojtjen e shëndetit mendor, në të cilën këshilltari shpirtëror ka një rol përmes mbikëqyrjes shpirtërore. Për më tepër, në thëniet e të Dërguarit të Zotit theksohet prioriteti i besimtarit të fuqishëm ndaj atij të dobët, ndërkaq fuqia nuk nënkupton vetëm aspektin fizik, por tërë qenien e njeriut, respektivisht edhe aspektin fizik, mendor dhe shpirtëror.

Fleksibiliteti i intencave të legjislacionit islam

Këtu duhet nënvizuar se studiuesit bashkëkohorë në fushën e intencave të legjislacionit islam nuk i kanë kufizuar intencat e sheriatit

³ El Jeubij, Muhamed Sa’ed ibn Ahmed ibn Mes’ud, (1998/1418h), *Mekasidu esh sheria el islamijje ve alkatuha bil edil-leti esh sheri’ijje*, botimi i parë, Darul hixhre, Rijad, f. 37.

⁴ Shatibij, Ebu Is’hak Ibrahim ibn Musa Muhamed El Lahmij, (pa vit botimi), *El Muvafekat fi usuli esh sheri’a*, redaktuar prej: Muhamed Muhjudin Abdul Hamid, Mektebetu Alij Muhamed Subejh ve euladuhu, Kajro, vëll. II, f.8.

⁵ Shih: Esh Shatibij, Ebi Is’hak Ibrahim ibn Musa El Lahmij, (2017), *El Muvafekat*, botimi i parë, El Beshir bi Naëtijje, Fas-Maroko, vëll.III, f.18.

⁶ El Alim, po aty, f.80.

në mënyrë kategorike vetëm në pesë domosdoshmëritë që i kanë përmendur dijetarët klasikë: mbrojtja e fesë, jetës, mendjes, gjenezës dhe pasurisë. Përkundrazi, hapësira e tyre është shumë e gjerë dhe natyra e tyre është fleksibile. Siç thekson edhe Muhamed Nexhatullah Sidiki, kuadri i intencave të sheriatit jo vetëm që nuk mund të kufizohet, por gjithashtu nuk është e drejtë të thuhet se kufizohet vetëm në pesë domosdoshmëritë e përmendura. Këto domosdoshmëri paraqesin një bazë fleksibile, në të cilën mund të përfshihen edhe intenca të reja, si dhe elemente të tjera që mund të konsiderohen brenda kuadrit të pesë bazave.⁷ Më tej, Sidiki përmend dy arsye pse nuk pajtohet që kuadri i intencave të sheriatit të kufizohet në pesë domosdoshmëritë, dhe thotë:

“Shkaku i parë, siç thekson edhe Ibn Tejmije, është se kuadri i intencave të sheriatit nuk duhet të ngushtohet dhe kufizohet vetëm në kuptimin e mbrojtjes, por duhet patjetër që fusha e tyre të zgjerohet dhe të avancohet për të përfshirë interesat e zhvillimit, progresit dhe realizimit të dobive të tjera publike. Kjo, sepse lista që përmbledh intencat përqendron tërë fokusin vetëm në largimin e dëmeve, ndërsa aspekti i realizimit të dobive anashkalohe.

Shkaku i dytë, sipas mendimit të studiuesve bashkëkohorë, është se në dritën e ndryshimeve globale dhe sfidave të reja me të cilat përballlet bota sot - si çështja e ndotjes së ambientit, mbrojtja e burimeve natyrore dhe ndalimi i prodhimit dhe përdorimit të armëve të shkatërrimit në masë - zgjidhja më ideale që synon të realizojë këto qëllime fisnike gjendet në mësimet dhe parimet e legjislacionit islam. Ky legjislacion ofron një alternativë reale dhe të qëndrueshme për trajtimin e këtyre çështjeve. Më tej, autori thekson se mënyra më e mirë për t’u përballur me sfidat që sjell globalizimi është zgjerimi i kuadrit të intencave të sheriatit, duke përfshirë në to vetëm çështjet që janë vërtet të dobishme dhe të provuara. Gjithashtu, ato që mbështeten me argumente nga Kur’ani dhe suneti, por që nuk kanë pasur më parë vëmendjen e duhur, duhet të integrohen në këtë kuadër”.⁸

Përkujdesja shpirtërore në dritë të intencave të legjislacionit islam

Nisur nga kjo, përkujdesja shpirtërore mund të shihet si një komponent thelbësor i intencave të legjislacionit islam, duke u integruar

⁷ Sidiki, Muhamed Nexhatullah, (2016), *Mekasidu esh sheri’a vel hayat el mua’sire*, botimi i parë, përktheu në gjuhën arabe: Muhamed Rahmetullah En Nedvij, Darul Kalem, Damask, f.46.

⁸ Shih: Sidiki, po aty, f.47-48.

përkrah pesë domosdoshmërive kryesore që duhen mbrojtur, siç janë mbrojtja e jetës dhe mendjes. Me plot të drejtë, përkujdesja shpirtërore mund të konsiderohet si një intencë e veçantë dhe të radhitet në listën e intencave të shariatit që kërkojnë vëmendje.

Këtë përfundim mund ta mbështesim në argumentet vijuese:

- **Mbrojtja e jetës** është një prej pesë domosdoshmërive që legjislacioni islam synon ta mbrojë. Kjo nënkupton mbrojtjen e njeriut si një tërësi shpirtërore dhe materiale. Kur flasim për mbrojtjen e jetës, nënkuptojmë dy aspekte: shpirtëroren dhe materialen. Për më tepër, mbrojtja e qenies njerëzore aludon në të gjithë njerëzit, pa përjashtim, në çdo gjendje - qoftë kur janë të gëzuar apo të pikëlluar, optimistë apo pesimistë, të qetë apo të trazuar shpirtërisht.

Kjo domosdoshmëri për përkujdesje shpirtërore është përforcuar në burimet themelore të Islamit, si Kur'ani dhe tradita profetike, të cilat theksojnë rëndësinë e mbrojtjes së jetës dhe qenies njerëzore. Kur'ani e përmend këtë në mënyrë të përmbledhur me nocionin e “**nderimit**”, siç ilustron në ajetin e mëposhtëm: *“Ne, vërtet nderuam pasardhësit e Ademit (njerëzit), u mundësuam të udhëtojnë hipur në tokë e në det, i begatuam me ushqime të mira, i vlerësuam ata (i lartësuam) ndaj shumicës së krijesave që Ne i krijuam”*.⁹

Ky nderim është një përgjegjësi e gjithanshme që përfshin përkujdesin për të gjitha aspektet e mirëqenies së njeriut, duke përfshirë shëndetin fizik dhe shpirtëror.

- **Mirëqenia e njeriut:** Mësimet islame, bazuar në dy burimet themelore të tyre, Kur'anin dhe traditën pejgamberike (sunetin), theksojnë qartë se një nga qëllimet kryesore të fesë islame është sigurimi i mirëqenies së njeriut. Legjislacioni islam mban një varg dispozitash që sigurojnë mirëqenien e njeriut, si në aspektin material, ashtu edhe në atë shpirtëror. Këto dispozita përfshijnë ndalimin e vjedhjes, plaçkitjes, dëmtimit të pronës së tjetrit, si dhe mbrojtjen e nderit, sigurisë dhe jetës së individit. Po ashtu, dispozitat mbrojnë njeriun nga shkelja e nderit dhe privatësisë, shpifjet, përgojimi, dëshmitë e rreme dhe ofendimet.

Kjo nënkupton se mirëqenia, qoftë materiale apo shpirtërore, është pjesë e rëndësishme e intencave të legjislacionit islam,

⁹ El-Israë: 70.

përkujdesja shpirtërore është një komponent thelbësor për arritjen e kësaj mirëqenieje. Allahu në Kur'an thekson: *“Allahu urdhëron drejtësi, bamirësi dhe ndihmë të afërmve, dhe ndalon nga imoraliteti, e neveritura dhe dhuna. Ju këshillon ashtu që të merrni mësim”*.¹⁰

Në lidhje me këtë, dijetari i shquar tunizian Et Tahir ibn Ashur thotë: “Nëse ne i induktojmë burimet e legjislacionit islam që flasin për intencat e tij, nga argumentet e tërësishme dhe parciale të induktuara të këtyre burimeve na bëhet e qartë se intenca e përgjithshme e legjislacionit është mbrojtja e sistemit të bashkësisë, vazhdimësia e mirëqenies së bashkësisë përmes mirëqenies së llojit njerëzor, e kjo e përfshinë mirëqenien mentale, mirëqenien e punës së tij dhe të mirave të kësaj bote ku njeriu jeton, që gjenden në disponim të tij”.¹¹

• **Drejtësia dhe ndalimi i diskriminimit - barazia:** Prej intencave kryesore të shariatit është drejtësia, andaj përkujdesja shpirtëror për të sëmurët, të burgosurit, azilantët dhe të gjitha shtresat e tjera të shoqërisë, është pjesë integrale e kësaj drejtësie që islami promovon. Kjo do të thotë se të gjithë kanë të drejtë për përkujdesje shpirtërore, pa përjashtim dhe pa diskriminim. Islami e ndalon diskriminimin e çfarëdo lloji, qoftë në aspektin social, ekonomik, juridik apo shpirtëror.

Kur flasim për barazinë në mësimet islame, shpeshherë i referohe mi aspekteve si barazia sociale, ekonomike dhe juridike, por drejtësia shpirtërore dhe mentale gjithashtu duhet të ketë vend në këtë kontekst. Në të vërtetë, mbrojtja e jetës, përfshirë aspektin shpirtëror dhe mendor, është një nga domosdoshmëritë që Islami e synon. Prandaj, të gjithë njerëzit, pavarësisht statusit të tyre shoqëror, gjendjes shëndetësore apo situatës juridike, kanë të drejtë për barazi në përkujdesjen shpirtërore dhe mendore.

Kjo qasje ndihmon në socializimin e grupeve të marginalizuara, siç janë të burgosurit, dhe luan një rol integrues për azilantët, duke siguruar që ata të mos përjashtohen nga përkujdesja shpirtërore dhe të mos diskriminohen në asnjë aspekt.

“Islami, duke e vërtetuar respektimin dhe dekorimin e njeriut si njeri, i ka mbyllur të gjitha dyert për justifikimin e diskriminimit dhe dallimit mes njerëzve mbi ndonjë aspekt si gjeneza, raca, përkatësia

¹⁰ En-Nahl: 90.

¹¹ Ibn Ashur, Et Tahir, (1366h), *Mekasidu esh sheri 'a el islamijje*, Mektebetul istikame, Tunizi, f. 63.

etnike, gjuha apo feja”.¹² Nisur nga kjo, përkujdesja shpirtërore që ofrohet në institucionet publike në Perëndim dhe në disa vende të tjera, shihet edhe në dritën e intencave të legjislacionit islam, në kuptim të drejtësisë, barazisë mes njerëzve dhe mos diskriminimit të tyre në asnjë aspekt.

• **Ndihma reciproke:** Mirësia dhe ndihma reciproke mes njerëzve janë mesazhe kyçe që burojnë nga Kur’ani. Ky angazhim për të mirën e njeriut dhe përpjekja për të eliminuar dukuritë negative që pengojnë zhvillimin e tij, është e theksuar në shumë ajete të Kur’anit. Një ndër mesazhet më të qarta është ajeti ku Allahu i Madhërishtëm thotë: **“Ju jeni populli më i dobishëm, i ardhur për të mirën e njerëzve, të urdhëroni për mirë, të ndaloni nga veprat e këqija dhe të besoni Allahun...”**

¹³ Ky ajet nënvizon rolin e rëndësishëm të ndihmës reciproke dhe veprimit për të mirën e njerëzimit.

Në çdo rast ku konstatohet se ka dobi për popullin, kjo përfshihet në intencat e legjislacionit islam.¹⁴ Solidariteti dhe ndihma ndaj njerëzve, qoftë në formë fizike, psikike apo shpirtërore, konsiderohet bamirësi, një nga objektivat themelore të legjislacionit islam. Ky mesazh i ndihmës reciproke është përmendur qartë edhe në ajetin: **“Ndihmohuni mes vete me të mira dhe në të mbara, e mosni në mëkate e në armiqësi. Kinie drojë dënimin e Allahut, se me të vërtetë Allahu është ndëshkues i fortë”**.¹⁵

Gjithashtu, i Dërguari i Allahut, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të, ka theksuar në shumë hadithe rëndësinë e solidaritetit dhe ndihmës së ndërsjellë. Ai ka thënë: **“Allahu do t’i ndihmojë robit, derisa ai t’i ndihmojë vëllait të vet”**.¹⁶ Kjo tregon se ndihma reciproke është një pjesë integrale e intencave të legjislacionit islam dhe një veprim që sjell përfitim shpirtëror për të gjithë.

I Dërguari i Allahut ka folur edhe për solidaritetin moral, e jo vetëm atë material. Në një hadith të tij, thotë: **“Kush ia largon besimtarit një brengë nga brengat e kësaj bote, Allahu nga ai do ta largojë një**

¹² Sidiki, po aty, f.55.

¹³ Ali Imran: 110.

¹⁴ Sidiki, po aty, f.58.

¹⁵ El-Maide: 2.

¹⁶ Hadithin me këtë version e ka shënuar Muslimi në Sahih-un e tij, kitabu: edh-dhikri ve ed-duai ve et-teubeti ve-l-istigfari, babu: fadli-l-ixhtimai ala tilaveti-l-Kur’ani ve ala edh-dhikri. Shih: en-Nevevij, Ebu Zekerija Jahja ibn Sheref, 1995, *el-Minhaxh fi sherhi Sahihi Muslimi ibni el-Haxhaxh*, botimi i parë, Daru-l-kutubi-l-ilmijje, Bejrut, vëll.XVII, f.18, hadithi nr. 2699.

brenjë nga brenjat e Ditës së Gjykimit. Kush ia lehtëson atij i cili është në vështrësi, Allahu atij do t'ia lehtësojë në këtë dhe në botën tjetër. Kush ia mbulon (një të metë) muslimanit, Allahu atij do t'ia mbulojë në këtë dhe në botën tjetër. Allahu do t' i ndihmojë robët, derisa ai t' i ndihmojë vëllait të vet".¹⁷

Këto hadithe janë frymëzuar nga fjalët e Allahut të Lartmadhërishtëm: ***"O ju që besuat, nuk bën të tallet një popull me një popull tjetër, meqë të përqeshurit mund të jenë më të mirë nga ata të cilët përqeshin dikë tjetër, e as gratë me gratë e tjera, sepse mund të ndodhë që gratë e tjera të jenë më të mira se ato që përqeshin (duke nënçmuar njëri-tjetrin) dhe mos etiketoni njëri-tjetrin me llagape. Pas besimit është keq të përhapet llagapi i keq. E ata që nuk pendohen, janë mi-zorë. O ju që keni besuar, largohuni prej dyshimeve të shumta, meqë disa dyshime janë mëkat dhe mos hulumtoni për zbulimin e të metave të njëri-tjetrit, dhe mos përgojoni njëri-tjetrin; a mos ndonjëri prej jush dëshiron të hajë mishin e vëllait të vet të vdekur? Atë pra e urreni! Kini frikë nga ndëshkimi i Allahut, e Allahu është mëshirues, Ai pranon shumë pendimin*".**¹⁸

"Kështu pra duhet të jetë komuniteti musliman, komunitet solidar ku të gjithë individët do të jenë të njësuar, të solidarizuar mes vete, duhet të formojnë shoqëri të fortë, humane, progresive, shoqëri e cila do të jetë shembull për tjerët në çdo gjë: sinqeritet, përparim, bujari, fisnikëri, ndihmë të ndërsjellë, bashkëpunim të dendur për një të ardhme më të mirë. Këtu e theksojmë elementin fetar dhe përkatësinë e besimit si bazë të fortë dhe shtytës të fuqishëm të solidaritetit. Përndryshe, solidariteti dhe humaniteti duhet të dëshmohej me të gjithë njerëzit, ngase është vlerë universale dhe parim islam."¹⁹

Nisur nga kjo, përkujdesja shpirtërore ndaj të gjitha shtresave të shoqërisë, si pacientët në spitale, të burgosurit, azilantët dhe të tjerët që kanë nevojë për mbështetje, duhet parë si një pjesë e rëndësishme e intencave të legjisllacionit islam. Kjo përkujdesje nuk është thjesht një akt humanitar, por një përmbushje e drejtpërdrejtë e parimeve dhe objektivave që synon Sheriati, përfshirë drejtësinë, mirëqenien dhe solidaritetin mes njerëzve.

Duke qenë se intencat e Sheriatit përfshijnë mbrojtjen e jetës, mendjes dhe shpirtit, ofrimi i përkujdesjes shpirtërore është një detyrim

¹⁷ Po aty.

¹⁸ El-Huxhuratë: 11-12.

¹⁹ Aliu, Bashkim, *Solidariteti, qasje nga këndvështrimi islam*, 2021, Furkan ISM, Shkup, f.17.

që Islami vendos mbi të gjithë, për të siguruar barazi, mbështetje dhe drejtësi për të gjithë pa diskriminim. Për këtë arsye, përkujdesja shpirtërore ndaj të burgosurve, azilantëve dhe të sëmurëve nuk duhet të shihet si opsional, por si një detyrë e qartë në përputhje me mësimet dhe qëllimet e legjislacionit islam.

Conclusions

- The role of spiritual care is gaining growing significance in public institutions across various countries and has become a topic of ongoing discussion and efforts toward systematization worldwide.

- With the arrival of migrants, asylum seekers, and workers in Western countries, many of whom are of Islamic faith, the demand for spiritual care for Muslims in public institutions has increased, particularly in hospitals, prisons, asylum centers, and care homes for the elderly.

- Initially, this service was provided by Imams-religious leaders within their communities-who were well-qualified to address spiritual and religious needs, offering essential spiritual care to those in need.

- An essential dimension of Islamic law is the *Maqasid al-Sharia* (Intents of Islamic Law), which represent the objectives that the legislation seeks to fulfill for the benefit and well-being of people.

- Spiritual care can be considered a distinct objective within the framework of Sharia, deserving special attention and protection.

- It is inherently linked to the five core imperatives that Islamic law seeks to safeguard, specifically the protection of life and intellect. This care extends beyond the physical realm, encompassing both spiritual and mental well-being.

- An important dimension of Islamic law is the *Maqasid al-Sharia* (Intents of Islamic Law), which represent the objectives that Islamic legislation aims to achieve for the benefit and welfare of people.

- Spiritual care can rightly be regarded as a distinct objective and included among the key aims of Sharia that warrant special attention.

- It is closely tied to the five essential necessities that Islamic law seeks to protect, particularly the preservation of life and intellect, ensuring care for both physical health and spiritual well-being.

- The protection of life is one of the five fundamental necessities that Islamic law is designed to uphold. This encompasses safeguarding individuals in both their spiritual and material dimensions. When

discussing the protection of life, we refer to both its spiritual and material aspects.

- One of the core objectives of Islam is to ensure the well-being of its followers. To this end, Islamic law includes a range of provisions aimed at securing the well-being of individuals, addressing both their material and spiritual needs.

- One of the key intents of Shari' a is justice, and providing spiritual care to the sick, prisoners, asylees, and others is an integral part of the justice promoted by Islam. This includes recognizing the right of these groups to spiritual care, ensuring that all segments of society-whether healthy or ill, free or imprisoned, residents or asylees-have access to spiritual and mental support.

- Solidarity with people and providing assistance, whether physical, psychological, or spiritual, is considered a form of charity in Islam. This act of charity is a fundamental aim of Islamic legislation, which seeks to ensure the welfare of all individuals within society.

Literatura:

El Alim, Jusuf Hamid. (Pa vit botimi). *El Mekasidul amme lish sheria el islamijje*. Darul hadith-Kajro & Al Dar Al Soudania for Books-Khartoum.

Aliu, Bashkim. (2021). *Solidariteti, qasje nga këndvështrimi islam*. Furkan ISM. Shkup.

Aslan, Edan et all. (2015). *Islamische Seelsorge. Eine empirische Studie am Beispiel von Österreich*. Springer VS. Viesbaden.

Badawia, T/Erdem G. (2023). Auf ein Wiedersehen im Hause der Dankbarkeit...! Aussprache, Bittgebet und Zwiegespräch als Medien der Verlustverarbeitung. In Badawia, T., und Erdem, G. (Hrsg.). *Muslimische Seelsorge im interdisziplinären Diskurs. Psychologie und Seelsorge in Begegnung* (S. 217-228). 1. Auflage. Kohlhammer. Stuttgart.

Belok, Manfred & Länzlinger, Urs & Schmitt, Hanspeter (Hg.). (2012). *Seelsorge in Palliative Care*. Theologischer Verlag. Zürich.

Cemil, Ş. (2018). *Seelsorge im Islam: Theorie und Praxis in Deutschland*. Springer VS.

Evangelisch-reformierte Landeskirche des Kantons Zürich (Hg.). (2019). *Seelsorge gestalten: nahe-vielfältig-profiliert*. 2.Auflage. Theologischer Verlag. Zürich.

El Jeubij, Muhamed Sa'ed ibn Ahmed ibn Mes'ud. (1998/1418h). *Mekasidu esh sheria el islamijje ve alkatuha bil edil-leti esh sheri'ijje*. Botimi i parë. Darul hixhre. Rijad.

Kutub, Sejjid. (1998). *Nën mbrojtjen e Kur'anit*. Shqipëruan nga boshnjakishtja: Selim Sylejmani dhe Hasan Bunjaku. Botim privat. Gjilan,

El Kurtubij, Muhamed ibn Ahmed El Ensarij. (1993). *El Xhami'ë li ahkamil Kur'an*. Darul kutubil ilmijje. Bejrut.

Lashin, Musa Shahin. (2002). *Fet-hul mun'im sherhu Sahihi Muslim*. Botimi i parë. Daru esh shuruk. Kajro.

en-Nevevij, Ebu Zekerijja Jahja ibn Sheref. (1995). *el-Minhaxh fi sherhi Sahihi Muslimi ibni el-Haxhaxh*. Botimi i parë. Daru-l-kutubi-l-ilmijje. Bejrut.

Nedžati, Muhammed Osman. (2021). *Kur'an i psihologija (Kur'an und Psychologie)*. Dobra knjiga. Sarajevo.

Er Rejsuni, Ahmed. (1412h). *Nedharijjetul mekasid indel Imam Esh Shatibijj*. Botimi i dytë. Ed Dar el alemijje lil kitabil islami. Rijad.

Esh Shatibijj, Ebi Is'hak Ibrahim ibn Musa El Lahmijj. (2017). *El Muvafekat*. Botimi i parë. El Beshir bi Naëtijje. Fas-Marok.